



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

RAPORTIMI MAJ - GUSHT 2017

FUSHA PRIORITARE 02: DREJTIM EKONOMIK

Moduli 02.01.11: Statistikat financiare të qeverisë – Metodologjia

Aktivitete të realizuara

1. Vlerësimi dhe dërgimi në EUROSTAT i treguesve PDT (EDP), 2013-2016.
2. Vlerësimi i njësive ekstra-buxhetore.
3. Ndërtimi i materialit shpjegues rreth ndryshimeve të fundit të PDT.
4. Ndërtimi i materialit shtesë të kërkuar nga EUROSTAT mbi PDT.
5. Ndërtimi dhe dërgimi i 3 tabelave të reja (***Tabela 0200*** - llogaritë kryesore të Administratës Publike, ***Tabela 0900*** - treguesit kryesorë të taksave, ***Tabela NTL*** - informacione të detajuara rreth strukturës së taksave) në EUROSTAT.
6. Pasqyrat Financiare të konsoliduara të qeverisë janë përgatitur në respektim të afateve të parashikuara. Pasqyrat financiare të këtij viti përmbajnë të dhëna edhe për disa njësi ekstra-buxhetore, që janë përgjithësisht Ndërmarrje Ujësjiellës-Kanalizime.

Aktivitete në proces

1. Statistikat Financiare të Qeverisë sipas Manualit të FMN-GFSM2014 janë përpiluar në format paraprak dhe do të jenë gati brenda datës 30 Shtator 2017 në format përfundimtar, në respektim të afateve të parashikuara.
2. Është finalizuar ndërtimin i listës së institucioneve publike për vitin 2016. Është përcaktuar një format publikimi i kësaj liste dhe është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë.
3. Kjo listë do të publikohet në faqen e web-it dhe do të ofrojë informacione rreth njësive buxhetore, extra-buxhetore dhe ndërmarrjeve publike në 4-mujorin e fundit.

Moduli 02.01.13: Statistikat mbi deficitin dhe borxhin publik – Prodhimi i të dhënave

Aktivitete të realizuara

Janë publikuar para datës 30.07.20 publikimet e borxhit për periudhën 01.05.2017-31.08.2017: Statistikat e borxhit, të cilat ofrojnë informacion mbi borxhin e brendshëm, borxhin e jashtëm, interesat e borxhit dhe borxhin e garantuar të qeverisjes së përgjithshme për tremujorin e dytë të vitit 2017.



FUSHA PRIORITARE 04: PERFORMANCA EKONOMIKE DHE SOCIALE

Moduli 04.01.11: SISTEMI EUROPIAN I LLOGARIVE

Aktivitete të realizuara

Në kuadër të implementimit të sistemit evropian të llogarive ESA 2010, DLLK ka punuar kryesisht në drejtim të përmirësimeve metodologjike dhe shfrytëzimit të burimeve të reja të informacionit. Përmirësimet më të rëndësishme që mund të përmendim janë:

1. U krye një vlerësim i burimeve të informacionit të nevojshme për llogaritjen e Shpenzimeve për Konsum Final të Familjeve (Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve, Anketa e Buxhetit të Familjeve) dhe u përdorën këto burime në vlerësimin final 2014, gjysëm final 2015, të publikuar në muajin Maj 2017.
2. Duke shfrytëzuar informacionin mbi kompensimin e të punësuarve dhe profesionet, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, u vlerësua “Own Account Software” për vitet 2013, 2014, bazuar në metodën e kostos së punës (labor cost approach).
3. Vlerësimi i CFC (seri kohore 1996-2014) për industrinë, duke përdorur metodën PIM. Punë e mëtejshme nevojitet për përmirësimin e sistemit ekzistues të PIM dhe gjithashtu në integrimin e elementëve të reja në të (Rritja e serive kohore, Përmirësimi i Indekseve të Çmimeve).
4. Një sistem prototip u zhvillua duke përdorur programin ESA Table Converter. INSTAT ka testuar me sukses këtë program me tabelën TP 0101Q.
5. U dokumentua metodologjia e përditësuar (GNI compilation) për komponentin e Konsumit Final të Familjeve, duke pasqyruar ndryshimet metodologjike të kryera për vlerësimin e këtij komponenti.
6. Transmetimi i vazhdueshëm i tabelave kryesore.
7. Tabela të reja të transmetuara.
8. Tabela 1001, 1200, 1300 sipas rajoneve (NUTS II-III).
9. PBB sipas metodës së Shpenzimeve – tre-mujore / të axhustuara sezonalisht.

Aktivitete në proçes

Tabela të reja të cilat do të transmetohen në raundin e ardhshëm të transmetimit janë:

1. Tabela e Burimeve me çmime bazë duke përfshirë transformimin në çmimet e blerjes – vjetore.
2. Tabela e përdorimeve me çmimet e blerjes – vjetore.
3. Tabelat simetrike input-output me çmime bazë – vjetore.
4. Formimi Bruto i Kapitalit Fiks sipas industrive $A*10 / A*21$ – vjetore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

5. Ndryshimet në Inventar sipas industrive A*10 / A*21 – vjetore.

Moduli 04.01.14: Llogaritë financiare- Metodologjia

Aktivitetet në proces

Metodologjia e hartimit të statistikave të llogarive financiare do të vihet në dispozicion të publikut brenda vitit 2017.

Moduli 04.01.15: Llogaritë financiare – prodhimi i të dhënave

Aktivitetet të realizuara

Deri tani janë mbledhur, përpunuar dhe hartuar të dhënat për korporatat e tjera depozituese, bankën qendrore, fondet e investimeve dhe ndërmjetësit financiarë.

Aktivitetet në proces

1. Publikimi për herë të parë i llogarive financiare për sektorin e korporatave financiare brenda vitit 2017.
2. Mbledhja e informacionit nga ndihmësit financiarë dhe kompanitë e sigurimit.

Moduli 04.01.16: Treguesit monetarë dhe Financiarë

Aktivitetet të realizuara

1. Prodhimi në kohë dhe me cilësi i treguesve statistikorë. Treguesit janë tashmë të konsoliduar, hartohen dhe publikohen në kohë sipas kalendarit të publikimeve dhe në përputhje me Programin dhe Strategjinë Afatmesme të Bankës së Shqipërisë (referojuni aneksit bashkëlidhur).
2. Raportimi i të dhënave në organizmat ndërkombëtare (FMN, EUROSTAT). Gjatë kësaj periudhe, ka përfunduar krijimi i faqes NSDP për raportimin e treguesve FMN në kuadër të projektit e-GDDS dhe janë raportuar në EUROSTAT dy pyetësorët T.2.1 Bilanci i Pagesave dhe T.2.2 Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare me periodicitet tremujor.

Moduli 04.01.22: Tabelat burime, përdorime dhe tabelat input-output

Aktivitetet të realizuara

Gjatë kësaj periudhe 4- mujore janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

1. Përpilimi i komponentëve të tabelave të burimeve dhe përdorimeve për vitin 2014.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

2. Analiza balancuese e tabelave burime-përdorime me çmime korente për vitin 2014 me nivel detajimi: 88 aktivitete x 88 produkte (nivel 2-shifror) sipas nomenklaturave Nace Rev. 2 për industrinë dhe CPA 2008 për produktet.
3. Deflatimi i komponentëve të tabelave burime-përdorime në nivel të detajuar produkti për përpilimin e tabelave burime-përdorime me çmime konstante.
4. Përshtatja e sistemit për përpilimin e tabelave burime-përdorime me çmime konstante për vitin 2014.

Aktivitetet në proces

1. Përpilimi i tabelave burime, përdorime me çmime korente për vitin 2014 me nivel detajimi 88 aktivitete sipas nomenklaturës Nace Rev. 2 dhe 88 produkte sipas nomenklaturës CPA 2008.
2. Përpilimi i tabelave burime, përdorime me çmime konstante për vitin 2014 me nivel detajimi 88 aktivitete sipas nomenklaturës Nace Rev. 2 dhe 88 produkte sipas nomenklaturës CPA 2008.

Moduli 04.01.23:Llogaritë rajonale

Aktivitetet të realizuara

Gjatë muajit Korrik u krye publikimi i treguesve të llogarive rajonale për serinë 2008-2015, i cili jep informacion mbi:

1. Vlerësimin e Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB) sipas rajoneve statistikore, niveli 2 dhe 3, dhe degëve kryesore të ekonomisë në seri kohore.
2. Vlerësimin e PBB-së sipas rajoneve statistikore, niveli 2 dhe 3 dhe degëve kryesore të ekonomisë në seri kohore.
3. Vlerësimin e PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore, niveli 2 dhe 3, si dhe të shprehura në termat e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPS).
4. Vlerësimin e PBB-së sipas aktiviteteve ekonomike Nace Rev 2, niveli rajonal statistikor 2 dhe 3.

Aktivitetet në proces

Përgatitja për publikim e materialit të zgjeruar të llogarive rajonale 2015 pritet të bëhet gati për publikun në 4 mujin e radhës.

Risqet dhe masat e marra për zvogëlimin/eliminimin e risqeve

Të dhënat jo-cilësore konsiderohen si risku më i madh i Drejtorisë, duke bërë që pjesa më e madhe e punës të fokusohet në kontrollë të nivelit mikro. Për këtë arsye, janë realizuar takime me sektorin e hedhjes së të dhënave dhe operatorët për problematikat e hasura gjatë hedhjes së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

të dhënave (data-entry) dhe janë asistuar nga vetë stafi në hedhjen e bilanceve.

Për të realizuar në kohë të gjithë objektivat e Drejtorisë është monitoruar puna ndërsektoriale, në përputhje edhe me afatet e aktiviteteve të parashikuara në GSBPM.

FUSHA PRIORITARE 05 QËNDRUESHMËRIA E MJEDISIT

Moduli 05.01.21: Llogaritë Monetare Mjedisore

Llogaritë Monetare Statistikore shërbejnë për të kuptuar situatën e sektorit të mjedisit në Shqipëri si dhe ekonominë e saj.

Aktivitete të realizuara

Statistikat vjetore mbi taksat në mjedis sipas industrisë janë publikuar për herë të parë në Korrik të vitit 2017. Taksat mjedisore konsiderohen si një instrument ekonomik për të kontrolluar ndotjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

Aktivitete në proces

1. Statistika vjetore mbi shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit dhe të ardhurat sipas PSZ 2017-2021 janë parashikuar të prodhohen në vitin 2019. Deri tani është punuar me analizimin e të dhënave administrative që nevojiten për këtë aktivitet dhe me analizimin e vazhdueshëm të manualëve të llogarive ekonomike mjedisore sipas standardeve evropiane, duke synuar zbatimin e Rregullores Nr 691/2011 të (BE) dhe Strategjinë Evropiane për Llogaritë Mjedisore.
2. Statistika vjetore mbi të mirat dhe shërbimet në mjedis sipas PSZ 2017-2021 janë parashikuar të prodhohen në vitin 2019. Deri tani është punuar me analizimin e të dhënave administrative që nevojiten për këtë aktivitet dhe me analizimin e vazhdueshëm të manualit të llogarive ekonomike mjedisore sipas standardeve evropiane, duke synuar zbatimin e Rregullores Nr 691/2011 të (BE) dhe Strategjinë Evropiane për Llogaritë Mjedisore.

Moduli 05.01.22: Llogaritë Fizike Mjedisore

Llogaritë Fizike Mjedisore janë të rëndësishme për të kuptuar ndikimin e faktorëve të ndryshëm industrial në mjedis, qarkullimit të produkteve të ndryshme të cilat kanë ndikim në mjedis si dhe ndotjes së ajrit dhe ujit nga materialet hozon hollues.

Aktivitete në proces



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

1. Përpunimi i të dhënave vjetore mbi llogaritë e emetimeve në ajër dhe në ujë, bazuar në të dhënat administrative sipas PSZ 2017-2021 janë parashikuar të prodhohen në vitin 2019. Deri tani është punuar me analizimin të dhënave administrative që nevojiten për këtë aktivitet dhe me analizimin e vazhdueshëm të manualit të llogarive të emetimeve në ajër dhe në ujë sipas standardeve evropiane, duke synuar zbatimin e Rregullores Nr 691/2011 të (BE) dhe Strategjinë Evropiane për Llogaritë Mjedisore.
2. Përpunimi i të dhënave vjetore mbi llogaritë rrjedhëse fizike në mjedis, bazuar në të dhënat administrative. Deri tani janë analizuar të dhënat administrative, manualët përkatëse dhe janë dërguar të dhënat në Eurostat duket ndjekur kërkesat e tyre.
3. Përpunimi i të dhënave vjetore mbi llogaritë rrjedhëse fizike të energjisë, bazuar në të dhënat administrative sipas PSZ 2017-2021 janë parashikuar të prodhohen në vitin 2019. Deri tani është punuar me analizimin e të dhënave administrative që nevojiten për këtë aktivitet dhe me analizimin e vazhdueshëm të manualit të llogarive rrjedhëse të energjisë mjedisore sipas standardeve evropiane, duke synuar zbatimin e Rregullores Nr 691/2011 të (BE) dhe Strategjinë Evropiane për Llogaritë Mjedisore.
4. Anketa mujore dhe tre-mujore e çmimeve të produkteve dhe inputeve bujqësore
5. Marrja e të dhënave administrative nga Ministri dhe Agjenci të ndryshme për Llogaritë Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis.
6. Statistika vjetore mbi taksat në mjedis.
7. Përditësimi i statistikave vjetore mbi llogaritë rrjedhëse fikse.
8. Analizimi i të dhënave administrative që nevojiten për llogarite ekonomike në mjedis dhe analizimin e vazhdueshëm të manualeve të llogarive ekonomike mjedisore sipas standardeve evropiane, duke synuar zbatimin e Rregullores Nr 691/2011 të (BE) dhe Strategjinë Evropiane për Llogaritë Mjedisore.

Risqet dhe masat e marra për zvogëlimin/eliminimin e risqeve

Mosdërgimi i të dhënave për statistikat e mjedisit nga institucionet përkatëse, si Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burime Natyrore.

Masat e marra janë:

1. Komunikime me shkresa zyrtare dhe e-maile duke ju kërkuar të dhënat dhe afatin e dërgimit.
2. Takime në institucionet përkatëse me personat përgjegjës.



FUSHA PRORITARE 06: STATISTIKAT E NDËRMARRJEVE EKONOMIKE

Moduli 06.01.51: Tregtia e Jashtme e Mallrave

Aktivitete të realizuara

1. Prodhimi i statistikave të Tregtisë së Jashtme të mallrave, import/eksport-i sipas grup-mallrave (mujore).
2. Prodhimi i statistikave të Tregtisë së Jashtme të mallrave, import/eksport-i sipas shteteve (mujore).
3. Prodhimi i statistikave të Tregtisë së Jashtme të mallrave, import/eksport-i sipas karakteristikave të ndërmarrjeve (vjetore)
4. Prodhimi i statistikave të Tregtisë së Jashtme të mallrave, import/eksport-i sipas mënyrave të transportit.
5. Marrja e informacionit nga DPD (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave).

Aktivitete në proces

Përdorimi dhe përditësimi i programit Eurotrace për përpunimin e të dhënave të import/export it 2017-2021.

Moduli 06.01.32: Statistikat e Turizmit

Aktivitete të realizuara

1. Grumbullimi, përpunimi dhe publikimi i të dhënave nga burimet administrative në njësi fizike, për periudha mujore.
2. Organizimi i vërtetimit mujor mbi kapacitetin dhe frekuentimin në njësitë akomoduese.
3. Publikimi i treguesve për hyrje-daljet e shtetasve të huaj dhe shqiptar sipas mënyrës së udhëtimit (ajër, det, tokë).
4. Publikimi i treguesve për hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit të udhëtimit dhe sipas shteteve.

Aktivitete në proces

Përpunimi i të dhënave, editimi, validimi i të dhënave nga vërtetimi i kryer për muajin Qershor dhe Korrik.



Nënmoduli 06.01.32.02: Statistikat e turizmit (familje)

Aktivite të realizuara

1. Kryerja në terren e Anketës së Turizmit “Pushime dhe Udhëtimet në Familje 2017” për tremujorin e parë dhe të dytë:
 - 1.1. Hartimi dhe finalizimi i buxhetit të anketës së Turizmit në Familje 2017.
 - 1.2. Dizënjimi i pyetsorit si dhe i manualit.
 - 1.3. Finalizimi i pyetsorit dhe manualit.
 - 1.4. Kryerja në terren e Anketës së Turizmit “Pushime dhe Udhëtimet në Familje 2017”, për tremujorin e parë dhe të dytë, në afat dhe cilësi nëpërmjet ndjekjes së ecures së terrenit si dhe kryerjen e kontrollove periodike.
 - 1.5. Ndjekja dhe mbështetja në ndërtimin e programit të hedhjes së të dhënave me kushtet logjike.
 - 1.6. Ndjekja e procesit të hedhjes së të dhënave të anketës për tremujorin e parë.
 - 1.7. Pastrimi dhe editimi i të dhënave të hedhura të tremujorit të parë.
2. Përfundimi i mbledhjes së të dhënave për tremujorin e parë dhe të dytë të anketës së turizmit në familje 2017.
3. Përgatitja e skedave për temat dhe nëntemat që i përkasin sektorit për faqen e re të web-ittë INSTAT.

Moduli 06.1.31: Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve

Aktivite të realizuara

1. Organizimi i vrojtimeve tremujore për prodhimin e treguesve statistikorë si: indekset e prodhimit industrial, indekset e shitjeve neto, indekset e punësimit, indekset e pagave, indekset e çmimeve të prodhimit, eksportit dhe importit, indeksin e kushtimit në ndërtim (për banesa).
2. Prodhimi i Indekseve të prodhimit industrial, shitjeve neto të punësimit, pagave, etj, për sektorët e ekonomisë: Industri, Ndërtim, Tregti, Shërbime të tjera. Në tremujorin e parë- 2017 të dhënat u publikuan me dhe pa përshtatje sezonale duke rritur nivelin e përpuethshmërisë së prodhimit të statistikave afatshkurtra me kërkesat e rregullores Evropiane mbi Statistikat Afatshkurtra.
3. Prodhimi i Indekseve të Çmimeve të Prodhimit, Eksportit, Importit, Kushtimit në Ndërtim.
4. Prodhimi i treguesve të Lejeve të Ndërtimit të miratuara.

Aktivite në proces

1. Përgatitja e serive kohore të statistikave afatshkurtra për transmetim në Eurostat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

2. Përgatitja për publikim e Metadatave referenciale dhe raporteve të cilësisë për treguesit e statistikave afatshkurtra.

Risqet

Mosmarrja në kohë e informacionit të duhur për prodhimin e treguesve statistikor.

Masat e marra për zvogëlimin/eliminimin e risqeve

Hartimi dhe zbatimi i një plan-veprimi ndërsektorial për aktivitetet e riskuara dhe monitorim i vazhdueshëm i ecurisë së aktivitetit në të gjithë etapat e planifikuara sipas GSBPM.

Moduli 06.01.22: Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve

Aktivitete të realizuara

1. Kryerja e trajnimeve të anketuesve, kontrollorëve dhe specialistëve përgjegjës për anketën në zyrat rajonale të realizuar në nivel Qarku.
2. Kryerja e vrojtimit statistikor vjetor pranë ndërmarrjeve ekonomike, me intervistim të drejtpërdrejtë ka filluar në 10 Maj dhe u mbyll në 1 Gusht. Janë angazhuar anketues dhe 17 kontrollorë.
3. Ndjekja e raportimeve javore të realizuar në nivel anketuesi, rrethi, kontrollori dhe operatori për të identifikuar në kohë problemet në raportim. Si edhe kontrollet në terren të vrojtimit për rrethet (përveç Tiranës).

Aktivitete në proces

1. Hedhja e të dhënave të ASN filloi në 5 Qershor nga data 15 Maj që ishte planifikuar. Është ende në proces edhe pse duhej të mbyllej në datë 11 Gusht! U angazhuan 216 anketues, 17 kontrollorë dhe 21 operatorë.
2. Integrimi i të dhënave administrative për vitin 2016 si edhe të dhënat e vrojtimit nga vitet paraardhëse në nivel ndërmarrje për studimin logjik të të dhënave të mbledhura nga anketuesi.

Risqet

Shtyrja e datës së publikimit të rezultateve paraprake nga shtyrja e Hedhjes së të dhënave dhe përfundimit të terrenit si edhe cilësisë së të dhënave.

Masat e marra për zvogëlimin/eliminimin e risqeve

Raportimi në GSBPM në çdo javë për të gjitha shtyrjet dhe problematikat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Moduli 06.01.61: Statistikat e kërkim zhvillimit

Aktivitete të realizuara

Editimi, imputimi dhe analizimi i skedarëve aktuale të Kërkimit Shkencor nën mbikqyrjen e misionit Suedez të organizuar gjatë fundit të muajit Maj.

Risqet

Mungesa e informacionit të sektorit publik riskon publikimin e rezultateve të KZH në nivel vendi.

Masat e marra për zvogëlimin/eliminimin e risqeve

Ngritja e problemit në takimet ndërinsitucionale të Kapitullit 25 në procesin e strategjisë kombëtare të KZH.

Moduli 06.01.62: Statistikat e Inovacionit

Aktivitete në proces

Misioni i planifikuar nga projekti SIDA për editimin, imputimin dhe publikimin e rezultateve të statistikave të Inovacionit.

Risqet

Mungesa e Statistikave të Inovacionit në nivel kombëtar.

Masat e marra për zvogëlimin/eliminimin e risqeve

Rivendosja në planet e SIDA Projekt për një mision në kuadër të Inovacionit gjatë pranverës së 2018.

Nënmoduli 06.01.63.01: Statistikat mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit

Aktivitete të realizuara

Editimi, përpunimi dhe tabulimi i rezultateve paraprake të TIK 2016.

Aktivitete të përealizuara

Editimi, përpunimi dhe tabulimi i rezultateve paraprake të TIK 2017.

Risqet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Pamundësia për nxjerrjen e Rezultateve Paraprake të TIK 2017 Brenda vitit si pasojë e mungesës së stafit ekspert.

FUSHA PRIORITARE 07: NJERËZIT E EVROPËS

Nënmoduli 07.01.21.01: Demografia

Aktivitete të realizuara

1. Ndërtimi i një sistemi statistikor të qëndrueshëm dhe të besueshëm për statistikat me burim administrativ.
2. Llogaritje e popullsisë sipas ndarjes urban/rural 2016-2017:
 - 2.1. Llogaritja e popullsisë sipas ndarjes urban /rurale si dhe numri i familjeve
3. Publikimi për Treguesit Demografik të T1 2017.
4. Bashkëpunimi me DPGjC për sigurimin e të dhënave të statistikave vitale.
5. Përpunimi i tabelave dhe grafikeve për Lindjet, Vdekjet dhe Shtesa Natyrore.
6. Përgatitja e formatit të publikimit për analizën e treguesve demografikë tremujorë.
7. Kontribut në botimet periodike të INSTAT:
 - 7.1. Përgatitja e tabelave për statistikat demografike për publikimin “Burra dhe Gra në Shqipëri.
 - 7.2. Përgatitja e tabelave dhe analizave për statistikat demografike për publikimin “Shqipëria në shifra 2017” duke e pasuruar publikimin me tregues të reja.
 - 7.3. Fillimi i punës për publikimin e Vjetarit Statistikor Rajonal.
8. Pasurimi me tabela dhe përditësimi i WEB-it:
 - 8.1. Përpunimi i tabelave dhe metodologjisë lidhur me statistikat demografike.
9. Reflektimi dhe përditësimi i aktiviteteteve në GSBMP, të statistikave demografike.

Aktivitete në proçes

1. Finalizimi i publikimit “Vjetari Statistikor Rajonal”.
2. Finalizimi i publikimit “Vjetari Statistikor”.
3. Finalizimi i publikimit Treguesit demografik T2 2017.

Nënmoduli 07.01.21.02: Migracioni

Aktivitete të realizuara

1. Marrja, kontrolli dhe përpunimi i të dhënave të migrantëve, si të huajt në Shqipëri, azil kërkuar, marrja dhe lënia e nënshtetësisë etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- 1.1. Takime mbi bashkëpunim me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit për të dhënat që disponohen.
- 1.2. Hartimi i shkresave për të dhënat që disponojnë DKM dhe Ministria e Brendshme.
- 1.3. Kontrolli i plotshmërisë së të dhënave, trendeve dhe përpunimi i tyre.
- 1.4. Krijimi i draft-format-it të publikimit të dedikuar Migrimit.
2. Reflektimi dhe përditësimi i aktiviteteteve në GSBMP, të statistikave demografike, të arsimit dhe shëndetësisë.

Aktivite në proces

Vazhdim i punës për mbledhjen e të dhënave, analizimin, krijimin e formatit për publikimin e botimit të dedikuar për statistikën e migracionit.

Nënmoduli 07.01.21.03: Projektionet e Popullsisë

Aktivite në Proçes

1. Puna me treguesit e projeksioneve në PSZ për të matur përputhshmërinë me metodologjinë e Eurostatit.
2. Fillimi i përgatitjes së tabelave dhe materialeve për projeksionet për vendosjen e tyre në PC-AXIS dhe në faqen veb.

Risqet dhe minimizimi i tyre

Përditësimi i projeksioneve është një aktivitet që kryhet për herë të parë dhe mungon praktika për këtë proces. Janë duke u shqyrtuar literaturat dhe mundësitë e ekspertizës për të siguruar një mbështetje nga ana teknike.

Nënmoduli 07.01.22.01: Censusi i Popullsisë dhe Banesave

Aktivite në Proçes

1. Përgatitjet për planin e aktiviteteteve dhe buxhetin përkatës nga Grupi Teknik i punës përgatitore të censusit.
2. Paraqitja e planeve dhe nevojave të INSTAT për aktivitetet e ndryshme të censusit në Mbledhjen e Donatorëve.
3. Pjesëmarrja e Përfaqësuesve të INSTAT në takimin e parë të Grupit Teknik të Koordinimit në Budapest për raundin e ardhshëm të CENSUS 2020 në Evropën Juglindore (TCG) ku u ndanë eksperiencat dhe praktikat më të mira për të harmonizuar metodologjitë dhe përkufizimet në nivel rajonal.
4. Zhvillime të mëtejshme për planet në lidhje me aktivitetet e Censusit dhe pasqyrimi i tyre



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

përsa i përket afateve kohore dhe buxhetit të nevojshëm të paraqitura dhe në mbledhjen e dytë të donatorëve.

5. Krijimi i njësive të ndryshme që do të operojnë me aktivitetet përgatitore të censusit sipas fushave: metodologji, IT, Kartografi, Administrim financë dhe menaxhim dhe fillimi i punës për amendimin e ligjit të Censusit.

Nënmoduli 07.01.22.02: Integrimi i migrantëve, lejet e qëndrimit, azilet, përforcimi i legjislacionit të imigrimit (EIL)

Aktivite të realizuara

1. Marrja, kontrolli dhe përpunimi i të dhënave të migrantëve, si të huajt në Shqipëri, azil kërkuarit, marrja dhe lënia e nënshtetësisë etj.

1.1. Takime mbi bashkëpunim me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit për të dhënat që disponohen;

1.2. Hartimi i shkresave për të dhënat që disponojnë DKM dhe Ministria e Brendshme;

1.3. Kontrolli i plotshmërisë së të dhënave, trendeve dhe përpunimi i tyre;

1.4. Krijimi i draft-formatit të publikimit të dedikuar Migrimit.

2. Reflektimi dhe përditësimi i aktiviteteteve në GSBMP, të statistikave demografike, të arsimit dhe shëndetësisë.

Aktivite në proces

Vazhdim i punës për mbledhjen e të dhënave, analizimin, krijimin e formatit për publikimin e botimit të dedikuar për statistikën e migracionit.

Moduli 07.01.31: Punësimi dhe papunësia

Aktivite të realizuara

1. Sigurimi i kryerjes në terren e Anketës së Forcave të Punës 2017 në afat dhe cilësi, nëpërmjet organizimit të punës së anketuesve, ndjekjes së ecurisë së terrenit si dhe kryerjes së kontrolleve periodike.

1.1. Realizimi i hedhjes në terren i anketës për tremujorin e tretë 2017.

1.2. Ndjekja e ecurisë së AFP_T2_2017, AFP_T3_2017 dhe supervizimi i punës në terren.

1.3. Përgatitja dhe kontrolli i skedarëve përfundimtarë të T2_2017.

2. Realizimi i përpunimit dhe publikimit në afat i rezultateve të AFP.

2.1. Kontrolli i kodifikimeve të profesioneve (sipas ISCO-08) dhe aktiviteteteve ekonomike (sipas NACE REV.2) T2_2017.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- 2.2. Pastrimi i të dhënave dhe derivimi i variablave të reja.
- 2.3. Përlllogaritja e treguesve, analiza dhe përgatitja e draft-it paraprak të publikimit të rezultateve të AFP_T2_2017
- 2.4. Përgatitja e tabelave për Web-in.
3. Hartimi i sintaksave për krijimin e variablave të skedarëve për dërgimin e micro-datave të AFP_2016 në Eurostat.
4. Punë për automatizimin e disa proceseve statistikore të AFP.
5. Realizimi i proceseve të llogaritjes së indikatorit mbi punësimin dhe papunësinë (të dhëna administrative):
 - 5.1. Përfundimi i procesit të kontrollit të të dhënave nga pasqyrat statistikore të programit statistikor, burim ZR dhe institucionet e tjera shtetërore.
 - 5.2. Përpunimi i të dhënave.
 - 5.3. Përgatitja e tabelave për WEB-in.

Aktivitetet në proces

1. Kryerja në vijimësi e Anketës Tremujore të Forcave të Punës 2017;
2. Kryerja e studimit pilot mbi zbatimin e standardeve të reja ndërkombëtare në AFP;
3. Përgatitja e tabelave bazuar në të dhënat e AFP për llogari të Drejtorisë së Llogarive Kombëtare;
4. Harmonizimi i variablave me formatet e Eurostat për transmetimin e të dhënave dhe standartizimi i proceseve statistikore.

Moduli 07.01.32: Kostot e punës dhe të ardhurat nga puna

Aktivitetet të realizuara

1. Kryerja e Anketës së Kostos së Punës 2016;
 - 1.1. Ndjekja dhe mbështetja në ndërtimin e programit të hedhjes së të dhënave me kushtet logjike;
 - 1.2. Supervizimi i punës në terren për mbledhjen e të dhënave;
 - 1.3. Supervizimi i procesit të hedhjes së të dhënave.

Aktivitetet në proces

Përpunimi i të dhënave të mbledhura të Anketës së Kostos së Punës 2017 (me vit reference 2016).



Moduli 07.01.33: Statistikat gjinore dhe diskriminimi

Aktivitetet të realizuara

1. Përgatitja e publikimit periodik të INSTAT “Burra dhe Gra” në Shqipëri.
 - 1.1. Hartimi i të gjithë shkresave me kërkesa për institucionet e treta duke u bazuar në treguesit e mëparshëm.
 - 1.2. Hulumtimi i botimeve të tjera dhe përfshirja e treguesve të rinj në këtë botim;
 - 1.3. Përgatitja e formateve të tabelave për sektorët e tjerë të INSTAT që furnizojnë me të dhëna për këtë publikim.
 - 1.4. Analiza e hendekut gjinor në paga bazuar në treguesit e pabarazisë gjinore në pagë me të dhëna administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
 - 1.5. Përgatitja e një workshopi në bashkëpunim me UN Women për prezantimin e botimit “Burra dhe Gra në Shqipëri” 2017.
 - 1.6. Prezantimi i publikimit “Burra dhe Gra” në Shqipëri
2. Publikimi “Shqipëria në shifra 2017”
 - 2.1. Publikimi u pasurua me statistika juridike, të kulturës dhe me tregues të barazisë gjinore.

Aktivitetet në proces

1. Fillimi i fazës së vlerësimit të treguesve të Barazisë Gjinore: është bërë identifikimi i treguesve të cilët mund të prodhohen dhe cilët jo. Ndërkohë nga ata tregues që prodhohen janë identifikuar ata që mund të prodhohen më shpejt.
2. Përditësimi i faqes së web-it, në lidhje me statistikën e krimeve.
3. Përgatitja e një raporti cilësie për statistikën gjinore.

Nënmoduli 07.01.41.01: Anketa e Buxhetit të Familje

Aktivitetet të realizuara:

1. Përfundimi i proceseve të Anketës së Buxhetit të Familjes 2016 dhe vazhdimi i proceseve të ABF 2017:
 - 1.1. Editimi dhe imputimi i të dhënave të ABF 2016;
 - 1.2. Përgatitja e tabelave dhe materialeve të tjera paraprake të ABF 2016;
 - 1.3. Përgatitja e tabelave dhe materialit shkrimor për publikimin e rezultateve kryesore me të dhënat e ABF 2016;
2. Kryerja në terren e Anketës së Buxhetit të Familjes 2017 (ABF) në afat dhe cilësi nëpërmjet ndjekjes së ecurisë së terrenit si dhe kryerja e kontroleve periodike.
 - 2.1. Përlogaritja e shkallës së përgjigjes së Anketës të Buxhetit të Familjes 2017.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- 2.2. Raportimi periodik lidhur me ecurinë dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të sektorit gjatë vitit 2017.
- 2.3. Dokumentimi i plotë në format elektronik dhe letër i të gjithë materialeve të anketës ABF 2017.
3. Sigurimi i aplikimit të nomenklaturës së produkteve dhe kontrolli i kodeve të produkteve në llogaritjen e treguesve kryesorë të shpenzimeve të konsumit bazuar në aktet ligjore të vendit dhe rekomandimet e EUROSTAT - COICOP 2012.

Aktivite në proces

1. Kryerja e draft- raport-it i cilësisë në versionin shqip për ABF 2016.
2. Përfundimi i materialit shkrimor për publikimin e të dhënave të ABF 2016.
3. Përgatitja e tabelave me të dhëna të ABF 2016 në formatin e duhur për përditësimin e web-it në PX-Web-it.
4. Ndjekja e ecurisë dhe mbarëvajtjes së ABF 2017.
5. Përgatitja e publikimit të botimit “Vjetari Statistikor Rajonal” 2012-2016 me të dhëna të ABF 2014 dhe ABF 2015.

Moduli 07.01.42: Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës

Aktivite të realizuara

1. Realizimi i Anketës SILC CAPI PILOT 2017:
 - 1.1. Printimi i pyetsorëve dhe manualit përkatës me qëllim trajnimi për realizimin e anketës SILC CAPI Pilot 2017;
 - 1.2. Përgatitja e hartave, listave dhe bazës materiale të nevojshme (kancelari etj.) për realizimin e anketës në terren;
 - 1.3. Përgatitja e procedurave të nevojshme për rekrutimin e Stafit që kreu anketën në terren;
 - 1.4. Realizimi i trajnimit të Stafit që kreu anketën në terren;
 - 1.5. Realizimi i Anketës në terren;
 - 1.6. Kontrolli, pastrimi dhe editimi i të dhënave;
 - 1.7. Përgatitja e tabelave dhe grafikëve mbi rezultatet kryesore të anketës.
2. Realizimi i proceseve të Anketës SILC 2016 (Vala1):
 - 2.1. Vazhdimi i kryerjes së procesit të pastrimit dhe përditësimit të programeve në SAS të valës së parë të anketës SILC 2016;
 - 2.2. Përgatitja e Peshave për Anketën SILC 2016 (Vala 1);
 - 2.3. Vlerësimi i të dhënave paraprake të SILC 2016;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- 2.4. Llogaritja e treguesve të varfërisë, pabarazisë, kushteve të banimit dhe deprivimeve;
- 2.5. Përgatitja e draft tabelave për analizim.
- 3. Puna për realizimin e Anketës SILC 2017 (Vala 2):
 - 3.1. Përgatitja e procedurave të nevojshme për rekrutimin e Stafit që do të kryejë anketën SILC 2017 në terren.
 - 3.2. Përgatitja e përditësimit të programit CAPI për mbledhjen e të dhënave të SILC 2017 (Vala 2) bazuar në CAPI PILOT 2017, testimi praraprak.

Aktivitetet në proces

- 1. Vlerësimi i të dhënave paraprake të SILC 2016.
- 2. Përgatitja e Fileve Finale sipas rekomandimeve të EUROSTAT të SILC 2016 (Vala 1).
- 3. Përgatitja e output-it paraprak (tabelave, grafikëve dhe analizës statistikore) mbi rezultatet kryesore të anketës SILC 2016.
- 4. Përgatitja e tabelave, grafikëve dhe analizës statistikore mbi rezultatet kryesore të anketës SILC PILOT CAPI 2017.
- 5. Përgatitja e sistemit CAPI dhe përditësimi i pyetsorëve dhe manualeve të SILC 2017 (Vala 2).

Nënmoduli 07.01.43.01: Të dhënat administrative mbi kriminalitetin dhe drejtësinë

Aktivitetet të realizuara

- 1. Ndërtimi i një sistemi statistikor të qëndrueshëm dhe të besueshëm për statistikat me burim administrativ:
 - 1.1. Hartimi i Memorandumeve të bashkëpunimit me Drejtorinë e Policisë dhe Ministrinë e Kulturës. Për këto memorandume është përgatitur lista e treguesve që INSTAT synon të publikojë bazuar në PSZ 2017-2021, si dhe frekuencat për të dhënat e kërkuara. Janë dërguar memorandumet finale në institucionet përkatëse dhe jemi në pritje të nënshkrimit të tyre si nga Policia dhe Ministria e Kulturës.
- 2. Harmonizimi i statistikave me kërkesat e EU-së:
 - 2.1. Vazhdimi i punës për implementimin e klasifikimit ndërkombëtar të krimeve për qëllime statistikore ICCS. Ky aktivitet ende kërkon kohë pasi nga Eurostat nuk kanë dalë ende rregulloret respektive. Megjithatë janë organizuar takime me aktorët pjesmarrës për t'i bërë me dije për këtë iniciativë të INSTAT si dhe fillimi i një hartëzimi nga Kodi Penal drejt ICCS. Gjithashtu jemi në pritje të një feedback-u edhe nga eksperti i IPA për statistikat e krimeve lidhur me kodifikimin e veprave, pjesë e pyetësorit të Eurostat (UN-CTS questionnaire).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- 2.2. Plotësimi dhe dërgimi i pyetësorit për statistikat e krimeve lidhur me formatin e ri sipas klasifikimit ndërkombëtar të krimeve, metadata përkatëse.
- 2.3. Rishikimi i treguesve të PSZ dhe shqyrtimi i përputhshmërisë me metodologjinë e Eurostatit.
3. Publikimi “Shqipëria në shifra 2017”
- 3.1. Publikimi u pasurua me statistika juridike, të kulturës dhe me tregues të barazisë gjinore.
4. Përgatitja për shtypin me të dhëna tremujore:
- 4.1. Statistikat e krimeve, Tremujori i parë dhe i dytë 2017.
5. Bashkëpunimi me institucione të tjera për ngritjen e kapaciteteve:
- 5.1. Finalizimi i raportit “Aksesi i fëmijëve në Drejtësi”, në bashkëpunim me UNICEF.
- 5.2. Përgatitja e një workshopi mbi gjetjet kryesore të raportit “Aksesi i fëmijëve në Drejtësi” të cilat u ndanë me institucionet të cilat ofruan të dhëna në dimensionet e ndryshme të aksesit të fëmijëve në drejtësi.
- 5.3. Finalizimi i raportit përfundimtar të projekt pilot PP7 për statistikat e krimeve për zhvillimin e mëtejshëm të statistikave të krimeve.
6. Hartimi i raporteve të cilësisë për statistikat e krimeve.

Aktivite në proces

1. Fillimi i punës për publikimin “Vjetari Statistikor” dhe “Vjetari Statistikor Rajonal”;
- 1.1. Hartimi i të gjithë shkresave për institucionet e treta duke u bazuar në treguesit e mëparshëm.
- 1.2. Përgatitja e tabelave dhe grafikëve si dhe materiali shkrimor për statistikat e krimeve.
2. Përditësimi i faqes së veb-it, në lidhje me statistikat e krimeve.
3. Vazhdim i punës për botimin e dedikuar për statistikat e krimeve.

Moduli 07.01.51: Arsimi

